



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:015068

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05413574

P.2020:015069

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, dhe bashkëpunëtori profesional Ismail Kuçi, në çështjen penale kundër të pandehurit Gj. R., i shpallur fajtor për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.2172-1/19 të datës 31.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datë 13.02.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Sadat Topalli, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij – Avokat A. F., përkthyes Z. K., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: Gj. R. me vendbanim në Rr, "...” nr... shkup , i lindur me datë ..., nga i ati B... dhe ëma K..., e gjinisë S..., profesioni arkitekt, i martuar, i papunë, i gjendjes së mesme, me numër personal ..., Maqedonas, shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 10.08.2019, rreth orës 09:50, në hyrje të Republikës së Kosovës në pikën kufitare në Han të Elezit, i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotik, ashtu që me rastin e kontrollit nga policia të automjetit ..., të modelit ... , ngjyrë hiri, të cilën e drejtonte i pandehuri, në sirtarin e ndërruesit shpejtësive i' u është gjetur një sasi e substancës së dyshuar narkotike e llojit marihuanë dhe një pako me letra për mbështjellje të marihuanës, pas ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka rezultuar se substanca narkotike është marihuanë me peshë 0,28gram.

-Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 te KPRK-së.

Andaj duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë në shumë 250€ (Dyqind e pesëdhjetë euro), të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet, me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara.

II. Konform nenit 269 paragrafi 3 të KPRK- së, substanca narkotike është marihuanë me peshë 0,28gram dhe një pako me letra për mbështjellje të marihuanës konfiskohen në mënyrë të përhershme.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 50.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2172-1/19 të datës 31.01.2020, kundër të pandehurit Gj. R., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 të KPRK-së, i ka propozuar gjykatës, që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 13.02.2024

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Mbrojtësi i të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e mbështesim pranimin e fajësisë pasi që e njëjta është bërë në konsultim me avokatin ku janë sqaruar benificionet lidhur me pranimin e fajësisë dhe konsiderojmë se janë plotësuar kushtet të procedurës që në këtë fazë të bëhet pranimi i fajësisë.

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve , substancave psikotrope dhe anloge nga neni 269 paragrafi 2 i KPRK-së, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare dhe korrekte duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë ky pranim është në përputhje të plote të nenit 242 të KPP-së, dhe i mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligji sa i përket llojit dhe lartësisë se dënimit i propozoj gjykatës që të ketë përsyshë rrethanat lehtësuese dhe renduese të parapare ne nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, që dënimi të jetë me proporcion me shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë të shkaktuar nga kjo vepër penale dhe i kërkoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit plotësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 te KPRK-së*, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se: i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, është penduar për veprimet që ka bërë, premtimin se nuk do të përsëris vepra penale në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për konfiskimin

Konform nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së, substanca narkotike është marihuanë me peshë 0,28 gram dhe një pako me letra për mbështjellje të marihuanës konfiskohen në mënyrë të përhershme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2020:015069, më datë 05.03.2024

Procesmbajtësi:

Ismail Kuçi

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.